



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK I AKCIZËS DHE PROCEDURAVE DOGANORE  
DREJTORIA E PROCEDURAVE DOGANORE

Nr. 19532/1 Prot.,

Tiranë, më 19/10 2020

URDHËR

Nr. 06/1, datë 19.10 .2020

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR "OPERATORËT EKONOMIK TË AUTORIZUAR"

Në kushtet kur, Bashkimi Europian krijoi konceptin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar mbi bazën e standardeve të njohura ndërkombëtarisht, duke krijuar në vitin 2008 një bazë ligjore në Kodin Doganor të Komunitetit dhe dispozitat zbatuese të tij, të cilin Dogana Shqiptare e ka përafruar gjerësisht, duke pasur si qëllim lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë së ligjshme, përmirësimin dhe rritjen e sigurisë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për të ecur paralelisht me zhvillimet legjislativë të BE-së;

Duke qënë se, koncepti "Operator Ekonomik i Autorizuar" bazohet në partneritetin Doganë Biznes, koncept ky i futur nga Organizata Botërore e Doganave (OBD) me qëllim që operatorët ekonomikë, me vullnet të lirë, të plotësojnë një sërë standardesh për të garantuar objektivin e përbashkët të sigurisë së zinxhirit të furnizimit;

Duke marrë parasysh se, ky koncept bazohet fuqimisht tek partneriteti doganë-biznes, i cili nënkupton që marrëdhëniet midis doganës dhe operatorëve ekonomikë duhet të bazohen gjithmonë në parimet e transparencës së përbashkët, korrektesës, paanshmërisë dhe përgjegjësisë;

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzuesit "Për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar", sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ky udhëzues nuk është një instrument ligjor detyrues por ka më shumë natyrë shpjeguese. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të garantojë një ide të përbashkët për autoritetet doganore dhe operatorët ekonomikë, si edhe të jetë një instrument për lehtësimin e zbatimit të rregullt dhe të harmonizuar të dispozitave ligjore të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar.

3. Udhëzuesi është një dokument që mbulon të gjitha instrumentet dhe procedurat e përdorura gjatë aplikimit për përfitimit e statusit "Operator Ekonomik i Autorizuar" si dhe procedurën e manaxhimit.

Ky urdhëzues hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GENTI CAZHELI**

